



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 434-8443 /2019

Klinë, dt. 06.02.2019

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare nr.28 me dt. 04.06.2008, në nenin 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës, të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh dispozitat e nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të MF nr.07/2011 për urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrimin e pagesës së tatimit në prone, në akordim edhe me këshillin e drejtorëve dhe kërkesën e Drejtorisë së Financave, nr.05-434-4417/19 të dt.30.01.2019, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 06.02.2019, **mori;**

V E N D I M

1. **OBLIGOHEN**, të gjitha kompanitë të cilat konkurrojnë me rastin e shpalljes së tenderëve dhe ofertave, të kryejnë obligimet e tatimit në prone si dhe taksat tjera komunale.
2. Me rastin e shpalljes së fituesit të tenderit komuna është e obliguar të kërkojë nga kompania vërtetimin e pagesës së tatimit në prone si dhe taksave tjera komunale pavarësisht se në cilën komune gjendet selia e kompanisë.
3. Në rast se kompania fituese e tenderit apo ofertave nuk e dëshmon me vërtetime kryerjen e obligimeve të lartcekura atëherë nuk do të lidhet kontrata.
4. Mbikëqyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi e bënë Drejtoria e Financave Ekonomisë dhe Zhvillimit në bashkëpunim me zyrën e prokurimit.
5. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- DFEZH;
- Zyra e prokurimit;
- Tabelën e shpalljeve;
- Arkivi.

